



Kosovo American Education Fund

Program i Partneritetit për Biznese

Ndihmo ekonominë e Kosovës – dhe krijo mundësi për të qenë konkurrent në të.

Fondi Kosovaro-Amerikan për Edukim (KAEF) është në kërkim të partnerëve të biznesit në mënyrë që ta përkrahin ata që nëpërmjet kontributit në edukim të arrihet zhvillimi ekonomik i Kosovës.

KAEF përkrah bizneset në Kosovë në afatgjatësi duke u ofruar liderëve të ardhshëm të biznesit edukim në universitetet më prestigjioze të SHBA-ve. Të diplomuarit e KAEF-it sjellin aftësitë substanciale në bizneset kosovare, duke implementuar praktikat më të mira ndërkombëtare dhe duke e bërë tregun kosovar më efikas, konkurrent, dhe tërheqës për investitorët potencial.

KAEF gjithashtu u ofron partnerëve të biznesit mundësinë e:

- **Promovimit përgjatë caktimit kyç** – të rinjët, të motivuar dhe edukuar të cilët vizitojnë web faqen www.kaef-online.org dhe aplikojnë në programin KAEF
- **Demonstrimit të përkushtimit në zhvillimin afatgjatë të Kosovës**
- **Rekrutimit të kuadrove të kualifikuara** nëpërmjet rrjetit të të diplomuarve, bursistëve dhe aplikantëve të KAEF-it
- Njoftimit të stafit me informatat më të reja mbi KAEF, njëherit duke ju ofruar **mundësinë e zhvillimit profesional**

KAEF çmon përkrahjen e partnerëve të tij të biznesit, dhe është i përkushtuar që t'i ndihmoj ata në arritjen e caqeve të tyre individuale.

Së bashku, në mund t'ju ofrojmë individëve mundësinë e të kontribuarit në zhvillimin e shoqërisë së tyre. Së fundi, për një shoqëri nuk mund të ketë përfitim më të madh.

Nivelet e Partneritetit

Donacion bamirës:
500 Euro në vit

Bashkëpunëtorët

- Bashkëpunëtorët nderohen në ueb faqe.
- Bashkëpunëtorët ftohen në gostinë vjetore të KAEF-it.

Donacion bamirës:
1,000 Euro në vit

Sponsorët

- Sponsorët nderohen në mënyrë të veçantë në ueb faqe.
- Sponsorët ftohen në gostinë vjetore të KAEF-it.
- Sponsorët mund t'i reklamojnë shpalljet për punë në listen e email adresave të KAEF-it.

Donacion bamirës:
2,500 Euro në vit

Partnerët

- Partnerët nderohen dukshëm ne ueb faqe.
- Partnerët mund t'i reklamojnë shpalljet për punë në listen e email adresave të KAEF-it.
- Partnerët mund të marrin pjesë në panairë pune të organizuara për semi-finalistët e KAEF-it, finalistët dhe të diplomuarit.
- Partnerët janë mysafirë të nderuar në gostinë vjetore të KAEF-it.
- Partnerët përmenden si përkrahës të programit në të gjitha ngjarjet dhe materialet për shtyp.

Bashkohuni në Rrethin e Miqëve të KAEF-it

Anëtarët e Rrethit të Miqëve të KAEF-it përfshijnë individët apo organizatat të cilat, nëpërmjet donacionit substancial demonstronjë leadershipin dhe vendosshmërinë e tyre që të ndikojnë me afatgjatësi në Kosovë. Megjithatë anëtarët e Rrethit të Miqëve të KAEF-it nuk kontribuojnë në program për të fituar privilegje nga planet për sponsorshipe, ata i marrin të gjitha privilegjet si Partnerët e programit KAEF. Si shtesë, llogoja e tyre së bashku me materialet dhe prezantimet vendoset përherë ne ueb faqen e KAEF-it. KAEF punon me dinamikë me anëtarët e Rrethit të Miqëve të tij në mënyrë që të sigurojë kënaqësinë e tyre në çfarëdo mënyre. Nëse jeni të interesuar që të bëheni anëtar i Rrethit të Miqëve, ju lutemi të na kontaktoni.



Kosovo American Education Fund

Program i Partneritetit për Biznese

Bashkangjituni në klubin e përkrahësve të KAEF-it!

Shumë organizata dhe biznese tashmë janë nënshkruar për ta përkrahur KAEF-in. Bashkangjituni në këtë klub ekskluziv të bizneseve të dedikuara, larg pamëse, duke kontribuar në KAEF sot!



OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU SH.A.
TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR J.S.C.
OPERATOR SISTEMA, PËRNDOSA I TRZISTA. A.D.



Web Faqja KAEF

Web faqja e KAEF-it – www.kaef-online.org - tërheq përafërsisht 1,200 vizitorë unik nga Kosova çdo muaj.

Vizitorët janë në përgjithësi të rinj, të edukuar, dhe individë të ngritur nga e tërë Kosova. Nuk ka vend më të mirë për të depërtuar në këtë shpërndarje të vlefshme. Për më shumë, duke u partnerizuar me KAEF, ju mund t'i tregoni vizitorëve te ueb faqes sonë që biznesi i juaj është i përkushtuar ndaj Kosovës.



Marka KAEF

Pas vetëm katër vitesh në Kosovë, programi KAEF njihet gjërësisht nga studentët dhe të diplomuarit universitar. Së afërmi, KAEF ka filluar të njihet edhe nga grup mosha të ndryshme në tërë vendin.

Përkrahja e bërë për KAEF-in, tregon që biznesi i juaj beson në mundësitë e edukimit, partneritetin Kosovë-SHBA, në transparencë, integritet, dhe përkushtim afatgjatë ndaj Kosovës.